



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2024, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 27.05.2024.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë "KROI MBRET ENERGJI" sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi zgjatjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 04.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mali” me kapacitet të instaluar 1490 kW”.
6. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s vendim nr. 111, datë 27.03.2023, mbi licencimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kW.